AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I6-S **Prot.** **Tiranë** 22/5 **/2026**
Nr.doc. 202600154/ S

Lënda: *Rekomandim për përmirësimin e kushteve të përgjithshme të jetesës si dhe gjithpërfshirjen e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Korçë.*

BASHKISË KORÇË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar me iniciativë ndjekjen e problematikës së ngritur nga media, sa i përket kushteve të jetesës dhe strehimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në qytetin e Korçës.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka nisur me iniciativë ndjekjen e kësaj problematike të raportuar nga Zyra Rajonale Korçë e Avokatit të Popullit, në të cilën shprehet shqetësimi lidhur me problematikën e kushteve të jetesës dhe aksesit në shërbimet e strehimit social për familjet rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, konkretisht në lagjen nr.10, zona e ish-Gjeologjisë, ku raportohet se rreth 32 familje (të rritura nga 19 familje fillestare të strehuara që prej vitit 2000) jetojnë prej vitesh në kushte të papërshtatshme higjieno-sanitare dhe në mbipopullim.

Avokati i Popullit e sheh me prioritet përmirësimin e kushteve të jetesës për pakicat, duke pasur parasysh se këto grupe përballen me kushte më të disfavorshme në krahasim me pjesën tjetër të shoqërisë. Për këtë arsye, përpjekjet për avancimin e kushteve të jetesës së tyre duhet të jenë më të përqendruara dhe të intensifikuara.

Për sa më lart, për qëllime të hetimit administrativ, i jemi drejtuar zyrtarisht Bashkisë Korçë[1]. Në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit lidhur me problematikën e strehimit, në lagjen nr.10, zona e ish-Gjeologjisë, ku raportohet se rreth 32 familje (të rritura nga 19 familje fillestare të strehuara që prej vitit 2000) për banorët e kësaj lagjeje, Bashkia Korçë informon se[2]:

*"Këto raste janë të njohura nga Drejtoria e Strehimit Social. Bëhet fjalë kryesisht për kategori prioritare, pasi familjet i përkasin minoritetit rom dhe egjiptian dhe ndodhen në kushte të theksuara pamundësie ekonomike, në shumicën e rasteve pa të ardhura. Një prej familjeve aktualisht mbështetet përmes programit Subvencionimi i qerasë që prej vitit 2024 dhe në vijim. Ndërsa lidhur me ndërtimin e banesave sociale në zonën e Traverbangut, bashkia na informon se ndodhet në procesin e sigurimit të Certifikatës së regjistrimit të Pasurisë në emër të saj" "Gjithashtu, Bashkia Korçë na informon se në lidhje me me projektin e banesave sociale në ish travabergut në kuadër të shtimit të fondit publik të banesave sociale Bashhkia Korçë po përgatit një projekt të zgjeruar zhvillimor, i cili mbështetet në zbatim të nenit 19 të ligjit nr.22/2018 " Për strehimin social", i ndryshuar. Ky projekt synon krijimin e banesave në pronësi të bashkisë, duke garantuar respektimin e parimeve themelore të strehimit social, akses të barabartë, integrim social, shmangie të segregimit dhe ofrim të një strehimi të qëndrueshëm dhe të përballueshëm për familjet në nevojë". **Sa i përket ndihmës ekonomike**, Bashkia Korçë, në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit për informacion lidhur me shërbimet për komunitetin rom dhe egjiptian na bën me dije se: Për vitin 2026 aktualisht në këtë lagje rezultojnë 30 familje përfituese nga skema e ndihmës ekonomike (banues të zonës ish-gjeologjia) dhe 20 familje banorë të lagjes nr.10 të cilat mbështeten në mënyrë periodike. Për vitin 2026, Bashkia Korçë nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit Social mbështet me subvencionim të plotë dhe të pjesshëm qiraje 29 familje /individë, nga të cilat 5 familje ju përkasin minoriteteve romë dhe egjiptiane. Familjet janë informuar dhe asistuar në mënyrë të vazhdueshme, si dhe kanë përfituar shërbime të specializuara nga zyrat e ndihmës ligjore falas, duke marrë këshillim dhe mbështetje për çështje të ndryshme ligjore në funksion të mbrojtjes së të drejtave të tyre. **Në lidhje me Projekt- Programet sociale** që zbaton, Bashkia Korçë bën me dije se ka mbështetur me kite shkolle 100 fëmijë nga familje në nevojë dhe një numër i konsiderueshëm i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian. Këta fëmijë mbështeten me çanta shkolle, mjete didaktike për tu ndjerë të gjithë të barabartë në procesin mësimor. Në dispozicion të këtyre familjeve është kampi veror Miqësia me synim pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete. Çdo vit mbështet familjet në nevojë duke i përjashtuar nga tarifat e kopshtit ose çerdhes. Gjithashtu Bashkia Korçë prej vitesh ka ngritur 3 qendra ditore për fëmijët romë dhe*

---

[1] *"Kërkesë për informacion" Nr.K1/16-2Prot datë 27.01.2026 si dhe "Kërkesë e përsëritur për informacion shtesë" Nr.K1/16-5 datë 12.03.2026.*

[2] *"Kthim Përgjigje"Nr883/1 Prot datë 17.02.2023 si dhe "Kthim pergjigje nr 883/3prot datë 19.03.2026".*

egjiptiane, ku ofrohet ushqim, aktivitete edukuese, fëmijët asistohen nga mësuesit për realizimin e detyrave të shkollës. Në dispozicion për moshën e tretë janë 4 qendra funksionale, një prej këtyre qendrave ndodhet në lagjen nr.10, zona e ish-Gjeologjisë. Familjet janë mbështetur me paketa ushqimore, higjieno- sanitar, dru zjarri, si dhe forma të tjera ndihme në funksion të përballimit të nevojave bazë. ***Sa i përket kushteve të strehimit****, hetimi administrativ nxjerr në pah se komuniteti rom i lagjes nr. 10 në Korçë, ndodhet në një situatë të papranueshme socio-ekonomike, e karakterizuar nga mungesa e infrastrukturës bazë, kushtet e rënda të banimit dhe mungesa e shërbimeve publike jetike. Këto mangësi nuk janë thjesht çështje zhvillimi apo ekonomike, por ngërthejnë dimensione të qarta të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, përsa problematika vijon të adresohet nga komuniteti, pranë institucionit të Avokatit të Popullit, masat e ndërmarra derimëtani rezultojnë të jenë të pamjaftueshme dhe të mbartura në kohë prej vitit 2000".*

***

Në rastin e banorëvë të Lagjes nr.10, zona e ish-Gjeologjisë, Avokati i Popullit identifikon disa aspekte thelbësore që e bëjnë përmirësimin e kushteve të strehimit dhe kushteve të përgjithshme të jetesës së këtyre banorëve, në një kohë sa më të shpejtë, si një prioritet kyç.

Për të përmirësuar kushtet e jetesës së qytetarëvë, anëtarë të komunitetit Rom, lidhur me kushtet e tyre të vështira të jetesës, strehimin, varfërinë e kulturën e traditat e tyre dhe për të siguruar që ata të jetojnë në përputhje me standardet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë, është e nevojshme të përmbushen detyrimet që rrjedhin nga angazhimet ndërkombëtare dhe nga kuadri i brendshëm ligjor dhe strategjik. Mungesa e kushteve minimale të jetesës së këtij minoriteti është një problem serioz që vështirëson integrimin e plotë të tyre në shoqëri. Kjo situatë krijon premisat që anëtarë të këtyre komuniteteve të ndihen të diskriminuar, të pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Për të mundësuar mungesën e përjashtimit për këtë komunitet nevojitet kuptim, dedikim dhe koordinim ndërinstitucional, i cili ka një rëndësi thelbësore për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të këtyre qytetarëve.

E drejta për strehim është një prej të drejtave themelore më të rëndësishme të njeriut, që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për jetën dhe shëndetin dhe si e tillë përfshihet në një numër të konsiderueshëm të instrumentave të së drejtës ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Deklarata Universale të Drejtave e të Njeriut, në nenin 25.1 të saj, parashikon që: "Çdokush ka të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij dhe të familjes së tij duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin".

Konventa të rëndësishme në nivel ndërkombëtar sanksionojnë rëndësinë e respektimit dhe garantimit maksimal të kësaj të drejte.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është pjesë e regjimit tonë të brendshëm juridik, dhe jurisprudenca e pasur në këtë drejtim e GJEDNJ, sanksionon të drejtën për strehim si një të drejtë themelore të njeriut.

Konventa e të Drejtave Ekonomike Sociale dhe Kulturore, kërkon marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të nxitur realizimin e së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Karta Sociale Europiane dhe Karta Sociale Europiane e Rishikuar, neni 16 "E drejta e mbrojtjes sociale, ligjore dhe ekonomike e familjes cilëson; *Me qëllim që të sigurojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, e cila është bërthama themelore e shoqërisë, Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin mbrojtjen e jetës familjare ekonomike dhe sociale me anë të mjeteve të tilla si përfitimet sociale dhe familjare, marrëveshjet fiskale, ofrimin e strehimit familjar, përfitime për të sapo martuarit dhe mjete të tjera të përshtashtme.*

" Neni 31 i Kartës Sociale Evropiane parashikon: *"Të drejtën e strehimit. Me qëllim që të garantojë zbatim efektiv të së drejtës për strehim, palët marrin përsipër masa të cilat:*

-nxisin aksesin tek strehimi i një standardi të përshtatshëm;

-nxisin dhe zvogëlojnë mosstrehimin me qëllim eleminimin e plotë të tij;

-ofrimin e çmimeve të shtëpive që janë të përballueshme për ata që nuk kanë mjetet e përshtatshme."

Sipas këtyre instrumentave ndërkombëtarë, e drejta për strehim duhet të nënkuptojë jo vetëm qiranë, por edhe kostot që lidhen me strehimin (si energjia dhe uji) duhen përcaktuar të tilla që pjesa e mbetur e të ardhurave të personit të jetë e mjaftueshme për t'i përballuar nevojat e tjera bazike. Shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore për strehim dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Sa më sipër, duhen pasur në konsideratë edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) për zbatimin e të cilave institucioni i Avokatit të Popullit kontribuon duke orientuar institucionet t'i qëndrojnë pranë qytetarëve më në nevojë, për të mos i rrezikuar pa ofrimin e shërbimeve. Një nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm është sigurimi i të gjithë qytetarëve, me prioritet shtresat në nevojë, për të patur të drejta të barabarta dhe qasje në shërbimet themelore. Deri në vitin 2030 duhet siguruar qasja në strehim të përshtatshëm, të

përballueshëm dhe të arritshëm për të gjithë. Zbatimi i Agjendës 2030 "Për Zhvillimin e Qëndrueshëm"[3] është thelbësor, për sigurimin e mirëqënies dhe gëzimit të të gjithë të drejtave për qytetarët. Angazhimi kryesor që "Asnjë të mos mbetet pas" përbën parimin kyç të të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

E drejta për strehim është sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 59, pika 1, gërma "b", lidhur me objektivat social, ku parashikohet shprehimisht se: "Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim". Nga ana tjetër sipas nenit 38 të Kushtetutës: "Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin e tij si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit", e drejtë kjo që kondicionohet me faktin se fillimisht duhet të kesh një banesë për strehim.

Theksojmë se ligjvënësi ka vendosur mekanizmat ligjorë dhe mjetet proceduriale në dispozicion të bashkive/organeve të pushtetit vendor, për të mundësuar që ato të vinë në ndihmë të shtresave në nevojë. Legjislacioni i shërbimeve sociale në thelb synon plotësimin e nevojave të shtetasve dhe familjeve të varfra. Sidomos kur kemi të bëjmë me familje/individë në nevojë për mbështetje, bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës është i rëndësishëm, me qëllim garantimin e mbrojtjes sociale, për identifikimin e vlerësimin e çdo rasti.

Në nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut cilësohen si "të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme", duke u bërë bazë e rendit juridik të vendit tonë. Ky përcaktim sanksionon barazinë dhe ndalimin e diskriminimit për të gjithë individët që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social", në nenet 3-10 të tij, parashikon parimet për strehim të përshtatshëm, duke përcaktuar edhe kriteret që e klasifikojnë strehimin e përshtatshëm.

Gjithashtu, referuar kuadrit ligjor në fuqi, konkretisht ligjit nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ligjin, nr.139/2015 për vetëqeverisjen vendore (ndryshuar me ligjin nr. 38/2019, datë 20.6.2019). VKM nr. 1093/2015 "Për Miratimin e Procedurave, Kritereve dhe Përparësive për Dhënien e Bonusit të Strehimi" organet e pushtetit vendor kanë detyrimin të garantojnë trajtim të barabartë, mosdiskriminimin dhe përparësi për grupet vulnerabël në procedurat e përfitimit nga programet e strehimit social dhe bonusit të strehimit.

[3] Kombet e Bashkuara (2015). Të transformojmë botën tonë: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Marrë nga https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication, e aksesueshme në dhjetor 2015.

Nga ana tjetër, mirëqeverisja, e cila afirmohet në mënyrë të veçantë nga Karta e të Drejtave Themelore e BE, duhet të konsiderohet si një koncept prioritar në veprimtarinë e përditshme të organeve publike. Rritja e standardit të shërbimeve publike të ofruara nga organet e administratës në cdo nivel është në qendër të politikave dhe angazhimeve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Europian dhe përafrimit të legjislacionit tonë me Acquis Communitaire. Një iniciativë që tregon angazhim në këtë drejtim është Dokumenti i politikave të standardeve të shërbimeve në Shqipëri, i cili shqyrton sfidat që hasen në përkufizimin e standardeve të shërbimeve publike, si dhe paraqet kornizën e përgjithshme dhe zgjidhjet praktike të politikave për të nxitur zhvillimin e standardeve të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve[4].

Së pari, ndërhyrjet në kohë dhe të vazhdueshme me qëllim adresimin e problemit të strehimit nëpërmjet programeve të strehimit social, ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit të përgjithshëm të anëtarëvë të këtij komuniteti.

Ndërgjegjësimi dhe ndihma juridike ndaj ketyre qytetarëve për të mundësuar aksesueshmërinë në shërbimet sociale, është një çështje kyçe për mirëqenien e banorëve dhe ky aspekt i rëndësishëm kërkon një përqasje të përshtatshme nga Bashkia.

Avokati i Popullit thekson se, hartimi i projekteve që adresojnë këto sfida nga Bashkia duhet të sigurojnë që ndërhyrja të jetë e shpejtë, efektive dhe e qendërzuar. Gjendja e krijuar me komunitetin Rom në lagjen në lagjen nr.10, zona e ish-Gjeologjisë, në Korçë identifikon nevojën e mbështetjes emergjente, por dhe të vazhdueshme e të përhershme, nëpërmjet marrjes së masave të shpejta dhe efikase, për krijimin e kushteve normale të jetesës, me qëllim arritjen e standardeve më të larta të integrimit të qytetarëve të këtij komuniteti nga ana e organeve me kompetenca ekzekutive dhe përfaqësuese, të Bashkisë Korçë.

Përkushtimi i organeve të qeverisjes vendore për të adresuar konkretisht nevojat emergjente të banorëve, anëtare të këtyre komuniteteve, nuk reflektohet vetëm me ekzistencën e këtij planeve vendore, por mbi të gjitha duke siguruar zbatimin e tyre në tërësi dhe në një kohë sa më të shpjetë. Kjo siguron që angazhimi për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e nje strehimi të përshtatshëm, të mos jetë vetëm një koncept, por të kthehet në ndryshim konkret dhe të qëndrueshëm në realitetin lokal.

[4] Dokument politikash për Standardet e Shërbimeve Publike në Shqipëri- https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/532

Përmes zbatimit të dokumentave strategjikë në nivel vendor, me afate konkrete, krijohet një rrugë e qartë për të arritur qëllimet e strategjisë kombëtare dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e veprimeve në nivel vendor.

Gjithashtu theksojmë se marrja e këtyre masave efektive shkon në të njëjtën linjë me përmbushjen e kritereve politike që Bashkimi Europian ka vendosur ndaj vendit tonë, si kusht për procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Konkretisht, një nga këto kushte ka të bëjë me, përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe të kushteve social-ekonomike, ku përfshihen si subjekte edhe minoritetet kombëtare në vend.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e një cilësie jetese më të mirë për anëtarët e komunitetit Rom, në lagjen në lagjen nr.10, zona e ish-Gjeologjisë Korçë bazuar në:

- Nenin 1, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ku thuhet shprehimisht se: *"Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave";*
- Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike";*
- Në vijim të nenit 21/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: *"Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:*
  paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut...".

REKOMANDOJMË:

1. Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale në Bashkinë Korçë, brenda 60 ditëve nga marrja dijeni e këtij rekomandimi, të kryejë një vlerësim të dokumentuar të situatës faktike në lagjen nr. 10, zona e ish-Gjeologjisë dhe të dorëzojë pranë Avokatit të Popullit një raport që përmban:
   a. *numrin e saktë të familjeve dhe individëve të prekur;*
   b. *listën e problematikave higjieno-sanitare konkrete (kanalizime, ujë i pijshëm,*
   c. *shërbime sanitare, etj.);*
   d. *numrin e familjeve pa dokumente të rregullta pronësie;*

e. *gjendjen aktuale të aksesit në shërbime publike bazë.*

2. Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave në Bashkinë Korçë, brenda 90 ditëve nga marrja dijeni e këtij rekomandimi, të miratojë dhe të dërgojë pranë Avokatit të Popullit një plan veprimi me afate konkrete për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare në lagjen nr. 10, që përfshin:
   a. *ndërhyrjet teknike emergjente (lidhje me rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve, grumbullim mbeturinash, infrastrukturë sanitare bazë);*
   b. *afatet për secilën ndërhyrje;*
   c. *buxhetin e planifikuar;*
   d. *strukturën përgjegjëse për zbatim dhe monitorim.*

Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, ju lutemi të na ktheni përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja e këtij rekomandimi, duke njoftuar masat e marra për zbatimin e tij.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Vilma SHERDHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AVOKATI I POPULLIT